

VENDIM
Nr.1198, datë 3.12.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.228, DATË 13.4.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DIETAT E NËPUNËSVE, QË DËRGOHEN ME SHËRBIM
JASHTË VENDBANIMIT TË TYRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, dhe të nenit 9 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.228, datë 13.4.2001 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kur punonjësit e ndërmarrjeve dhe të institucioneve, që financohen nga Buxheti i Shtetit, shkojnë me shërbim jashtë qendrës së tyre të punës dhe nuk kthehen brenda ditës në vendbanimet e tyre, përfitojnë:

- Dietë, në masën 10 për qind, të pagës mujore, por jo më shumë se 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë;

- Shpenzime fjetjeje, sipas dokumenteve të paraqitura, që e vërtetojnë atë, por jo më shumë se 3000 (tre mijë) lekë për çdo natë;

- Shpenzime udhëtimi, sipas vleftës së biletës së udhëtimit me transport hekurudhor, automobilistik dhe ujqor. Kur udhëtimi bëhet me taksi apo furgona, shpenzimet e udhëtimit paguhen sipas çmimeve të miratuara për linjën përkatëse me tren, autobus ose anije, plus 25 për qind të çmimit të biletës së transportit të linjës me autobus, dhe kur nuk ka linjë autobusi, të trenit apo të anijes.”.

2. Në pikën 4, shuma “...1400 (një mijë e katërqind) lekë“ bëhet “...2000 (dy mijë) lekë...”.

3. Në pikën 5, shuma “...600 (gjashtëqind) lekë...” bëhet “...1000 (një mijë) lekë...”.

4. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Kur shërbimi kryhet, në zona me largësi deri në 100 km, nga qendra e punës, dhe brenda orarit zyrtar të punës nuk paguhet dietë.”.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxhetet e institucioneve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha